AKTUALITET

Ekzekutohet në derën e shtëpisë 43-vjeçari Shkëlzen Velaj, i vëllai vdiq në "Masakrën e Çoles", autorët e ndoqën me kallashnikov deri në katin e 5-të, 30 gëzhoja tek hyrja e apartamentit! (ZHVILLIMET)

Shkëlzen Velaj u vra sot! I vëllai iu ekzekutua para gjashtë vitesh bashkë me dy miqtë e tij

KRIMI 'zhvendoset' në shtëpinë e tij në Vlorë, nuk shpëton as Lushnja, autorët qëllojnë pa mëshirë

Misteri: Kush është Shkëlzen Velaj, s'iu kursye jeta para syve të nënën, PISTAT ku po hetohet

Vritet Shkëlzen Velaj! 5 minuta para mesnate, Velaj u qëllua me kallashnikov në pragun e shtëpisë, në katin e 5 të pallatit ku jetonte në rrugën "Çole". Autorët, të cilët dyshohet se ishin 2 persona, e kanë ndjekur për kohë të gjatë dhe e kanë ekzekutuar në banesë. 43-vjeçari ishte vëllai i Ardi Velajt. Ky i fundit u vra në ngjarjen që ka marrë emrin "Masakra e Çoles". Atenatorët kanë djegur makinën në rrugën e lumit të Vlorës.



Shkelzen Velaj dhe pamje nga vendi i ngjarjes

3 Qershor, 2021 0:35 Përditësuar: 8:39

VLORË – 5 minuta para orës 00:00, **Shkëlzen Velaj** u qëllua për vdekje në derën e shtëpisë, teksa përpiqej që t'i shpëtonte me vrap **atentatorëve.** 43-vjeçari **Shkëlzen Velaj** sapo kishte mbërritur poshtë pallatit ku jetonte në lagjen Çole të Vlorës, kur nga pasqyra kishte dalluar një makinë të dyshimtë që e kishte ndjekur deri në shtëpi.

I frikësuar nga ajo që mund të ndodhte, i riu ka lënë makinën ndezur dhe është nisur me vrap duke ngjitur shkallët e pallatit për t'u strehuar në banesën e tij, ku e priste e ëma. Por kjo nuk i ka penguar autorët, të cilët dyshohet se ishin dy. Ata i janë vënë pas të riut dhe në momentin që i është afruar derës së apartamentit e kanë "shkundur" karikatorin e armës tip "*kallashnikov",* duke lënë në vendin e ngjarjes mbi 30 gëzhoja. Plumbat e marrë, kryesisht në bark, i kanë marrë jetën të riut.

Fqinjët kanë rrëfyer se në momentin e fundit, para krismave kishin dëgjuar të riun që t'i kërkonte të ëmës që t'i hapte derën. Por e moshuara nuk e ka dëgjuar pasi vetëm pak sekonda më pas ndaj tij u zbraz karikatori. Atentati dyshohet të jetë kryer nga 2 persona të paidentifikuar, të cilët pas atentatit janë larguar në drejtim të rrugës së lumit të Vlorë dhe në afërsi të fshatit Babicë kanë braktisur makinën tip BMW pa targa të cilën e kanë djegur. Brenda në makinën e djegur policia ka gjetur dhe kallashnikovin me të cilin autorët qëlluan viktimën.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, **Dosja.al**

Shkëlzen Velaj është vëllai i Ardi Velaj, i mbetur i vrarë në "Masakrën e Çoles", e ndodhur në 2015-ën. Pista e hetimit të vrasjes së 43-vjeçarit është hakmarrja e nxitur si pasojë e vrasjeve të ndodhura në vite, të nisura që nga ajo e Çoles. 'Masakra e Çoles' që nisi pas një sherri mes disa të rinjve në një kazino dhe mbetën të vdekur 3 persona, ka nxitur një seri vrarjes në qytetin e Vlorës përgjatë viteve. Në ngjarjen e 2015 e cila pasoi me një sërë ngjarjesh dhe viktimash janë përfshirë vëllezërit Llanaj. Si pasojë e plumbave mbetën vrarë tre persona, Ardi Velaj, Akil Hasanaj dhe Albi Limaj.

(k.m/f.m/a.b/f.g/dosja.al)

STAY CONNECTED

Facebook LIKE
Twitter FOLLOW
Instagram FOLLOW
Youtube SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT



3 Qershor, 2021 12:33

Po nisej drejt Anglisë, policia portugeze i 'pret ne mes' ëndrrën shqiptarit, kapet në aeroportin e Lisbonës

3 Qershor, 2021 12:31

Vrasjet e Vlorës fusin në sherr policinë, shefat e rrethit të pakënaqur: Nga Tirana na japin urdhëra, 60% e policëve janë në terren për kanabisin, krimi ka marrë revansh, lagjet janë kthyer në lapidare (E PLOTË)



3 Qershor, 2021 12:30

Dikur ylli i holandës, sot një këngëtar "trashaluq"



3 Qershor, 2021 12:28

Ç'po ndodh në Gjykatën Kushtetuese?

12:24 - **Vrasjet e Vlorës fusin në sherr policinë, shefat e rrethit të pakënaqur: Nga Tirana na japin urdhëra, 60% e policëve janë në terren për kanabisin, krimi ka marrë revansh, lagjet janë kthyer në lapidare (E PLOTË)**

Vrasja e Shkëlzen Velajt pak para mesnate në qytetin e Vlorës ka mbushur kupën në raportet e brendshme të Policisë së Shtetit. Gazetari i Fax Neës, Fatjon Gjinaj, raportoi se ka një debat shumë të fortë mes strukturave në varësi të Ardi Veliut për shkak të raporteve mes qendrës dhe rretheve. Ky debat ka nisur rreth një muaj më parë që prej nisjes së vrasjeve të njëpasnjëshme në Vlorë.

Njëra palë kërkon më shumë angazhim të policisë në aksionet e parandalimit të ngjarjeve kriminale si ajo e të mërkurës në mbrëmje, ndërsa pala tjetër kërkon zbatimin e urdhërave nga Tirana për kontrollin e territorit për goditjen e kultivimit të bimëve narkotike si dhe aksionet e ndërmarra së fundmi për ndërtimet pa leje në vijën bregdetare por edhe në zonat turistike.

Madje ka pasur edhe akuza dhe hipoteza nga këta të fundit, se pala tjetër po kërkon t'i lëshohet terren narkotikëve, ndërsa krimi ndaj jetës në fakt e ka kthyer shumicën e lagjeve dhe fshatrave të Vlorës në 'lapidare'. Në këtë rast duke iu referuar të njëjtit burim, rreth 60% e policisë është angazhuar kundër kultivimit të drogës dhe ndërtimeve pa leje, duke i lënë terren dashje-padashje krimit ndaj jetës që ka marrë revansh.

11:39 - **Shtëpinë e kishte 'blinduar'/ I ruhej një atentati të mundshëm, Shkëlzen Velaj kishte vendosur kamera sigurie në banesë**

43 vjeçari Shkëlzen Velaj i cili u vra mbrëmë në derë të shtëpisë i ruhej një atentati të mundshëm. Në shtëpinë e tij kishte vënë kamera sigurie të cilat kanë kapur dhe momentin kur ai është qëlluar nga autorët me 20 plumba. Policia ka sekuestruar kamerat e sigurisë dhe përmes tyre do të zbardhë ngjarjen.

11:00 - **Ishte bamirësi i lagjes! Kush është Shkëlzen Velaj, s'iu kursye jeta para syve të nënën, PISTAT ku po hetohet, e shkuara problematike e të vëllait dhe lëvizja atipike e 'bandave të rrugës' (MISTERI I EKZEKUTIMIT)**



Shkëlzen Velaj

Qyteti bregdetar i Vlorës u trondit 5 minuta pas mesnate nga dhjetra të shtëna kallashnikovi. Pasoja: ekzekutimi i Shkëlzen Velajt. 42-vjeçari, duke shkelur orën policore po kthehej në shtëpi, kur nga pasqyra dalloi një makinë që e ndiqte nga pas. I frikësuar për jetën e tij, nxitoi të hynte në banesë por plumbat e nxjerrë nga tyta e armës së autorëve i morën jetën në vend.

Po kush ishte Shkëlzen Velaj?

42-vjeçari deri më tani nuk rezulton si person që ka pasur precedentë të mëparshëm penalë dhe fqinjët e tij e përshkruajnë si një njeri të qetë, madje shumë ndihmues ndaj komunitetit. Në prononcimet e tyre për mediat, ata janë shprehur se i riu madje kishte paguar për shtrimin e rrugës së lagjes, duke përmendur dhe vepra të tjera për komunitetin. Por cili ishte burimi i parave të "bamirësive" të 42-vjeçarit? Edhe pse kanë kaluar disa orë nga vrasja ende nuk është zbardhur profesioni i tij, megjithatë një nga pistat kryesore ku po heton Policia është ajo e larjeve të hesapeve për trafik lëndësh narkotike. Po ashtu, një tjetër ngjarje e 6 viteve më parë mund të ketë sjellë ekzekutimin e të riut. Pas një sherri të nisur në një lokal në të njëjtën lagje, u qëllua për vdekje vëllai i tij, Ardi Velaj. Megjithatë nuk bëhet fjalë për një sherr banal. E ashtuquajtura 'Masakra e Çoles', ku dhe mbetën të vdekur 3 persona, ka nxitur një seri vrarjes në qytetin e Vlorës përgjatë viteve. Fillmisht në sherr u përfshinë Akil Hasanaj dhe Ardi Velaj, të cilët kanë ofenduar dhe dhunuar Xhuliano Lutajn. Ky i fundit ka kërkuar ndihmë dhe ka vënë në dijeni shokun e tij, Albi Limaj. Dhe pas një takimi në një tjetër lokal, të rinjtë nxorrën armët duke lënë të

Seanca për shembjen e TK, përfaqësuesi i qeverisë: Dokumentet që do Presidenca s'janë detyrim ligjor

Aleanca për Media Etike
Artikull joetik?
raporto këtu

vdekur në vend: Ardi Velaj, Akil Hasanaj dhe Albi Limaj. Të jetë vrasja e Shkëlzen Velajt, pjesë e këtij zinxhiri? Nëse vetë autori ose iniciatori i sherrit ka mbetur viktimë e sherrit, përse autorët kanë kërkuar të marrin hak tek vëllai? Kjo është një lëvizje atipike për larjen e hesapeve mes grupeve kriminale në Shqipëri. Ndoshta punën e lënë përgjysmë nga i vëllai e ka vazhduar Shkëlzeni, por kjo pritet që të hetohet nga Policia dhe Prokuroria e Vlorës. Sa më shpejt, para se të ketë viktima të tjera.

10:56 - Ekzekutimi i Shkëlzen Velajt/ Forcat Speciale RENEA zbarkojnë në Vlorë, në kërkim të autorëve, pistat kryesore të hetimit

Forcat RENEA

Në Vlorë kanë zbarkuar forcat speciale RENEA për të bërë të mundur identifikimin dhe kapjen e ekzekutorit të Shkëlzen Velajt.Deri më tani, dy janë pistat kryesore të hetimit, një ka të bëjë me hakmarrjen ndërsa nuk përjashtohet dhe përfshirja në trafikun e drogës. 35-vjeçari u qëllua mbrëmjen e djeshme nga 20 plumba, 15 të cilat e kapën në bark. Në momentin që Velaj pikasi autorët, u nis me vrap në drejtim të banesës së tij, mirëpo autorët e qëlluan me kallashnikov. Deri më tani janë shoqëruar në polici 10 persona pasi mund të kenë dijeni për ngjarjen, madje disa prej tyre kanë pasur konflikte me Velajn.

10:46 - "Me hidhërim të thellë..."/ U vra në prag të derës, 5 minuta pas mesnate, FOTOJA e re e Shkëlzen Velajt, përcillet sot në banesën e fundit

Shkëlzen Veliaj u vra 5 minuta pas mesanate jashtë derës së apartamentit të tij në lagjen "Çole" të Vlorës. Varrimi i tij do të bëhet sot, në orën 17:00. Familjarët kanë njoftuar se 42-vjeçari do të përcillet për në banesën e fundit sot, pasi të kryehet ekspertimi mjeko-ligjor.

"*Me hidhërim të thellë lajmërojmë ndarjen nga jeta e të dashurit tonë,"* shkruhet në njoftimin e vdekjes së 42-vjeçarit.

Njoftimi i Agjensisë Funerale

9:47 - Vrasja e Shkëlzen Velajt, flasin fqinjët: Ishte njeri i mirë, na bënte rrugët, nuk na pranonte as para

Fqinjët e 43-vjeçarit Shkëlzen Velaj, që u vra pak pas mesnate në lagjen Çole në Vlorë, pohojnë se i riu ishte një person pa probleme në pallat. Të pyetur nga mediat, ata kanë thënë se i riu ishte një fqinj i rregulltë.

"*Djali i kishte thënë hape dere, sa vajti ajo për ta hapur e gjeti djalin të vrarë. Të ëmën e mori policia dhe për vdekjen i kanë thënë pas orës 2:30 të natës", tha një nga fqinjët e 43-vjeçarit që u vra në derën e shtëpisë. Këtu për pallatin djali nuk kishte fare probleme, madje ka paguar lekë që ka shtruar rrugën në lagje dhe për ne ishte një njeri shumë i rregull. Grua më të mirë në botë se e ëma e tij nuk gjen në botë. Është një fatkeqësi shumë e madhe", tha një tjetër banor për mediat.*

9:37 - Vrasja e Shkëlzen Velajt, flasin fqinjët: Ishte njeri i mirë, na bënte rrugët, nuk na pranonte as para

Fqinjët e 35-vjeçarit Shkëlzen Velaj, që u vra pak pas mesnate në lagjen Çole në Vlorë, pohojnë se i riu ishte një person pa probleme në pallat. Të pyetur nga mediat, ata kanë thënë se i riu ishte një fqinj i rregulltë. "*Ishte njeri i rregulltë, këtu në pallat nuk kishte probleme. Bënte rrugët, nuk na pranonte as para"*-thonë ata.

9:17 - "O ma hape derën, hape derën", fjalët e fundit që Shkëlzen Velaj i tha të ëmës, e moshuara s'e dëgjoi, mund t'i kishte shpëtuar jetën

Foto ilustruese

Detaje të reja janë mësuar lidhur me vrasjen e Shkëlzen Velajt, dje në orët e para të mëngjesit. Pasi vuri se po ndiqej nga atentatorët, 35-vjeçari nxitoi për të dalë me vrap nga makina dhe u ngjit me vrap në shkallë. Por autorët nuk u ndalën dhe e ndoqën nga pas duke e qëlluar me breshëri automatiku. Në një prononcim për FaxNews, dqinjët rrëfejnë se nëna nuk ka mundur që të hapte derën pas thirrjes së djalit të saj, për shkak se ka qenë e tronditur nga të shtënat.

"Isha atje deri vonë, nëna e mori vesh, për vdekjen i thanë pas orës 2 e gjysmë. Djali i kishte thënë hape derën hape derën, dhe se kishte hapur dot nga zhurma, se ishte tramaksur,"- shprehet një fqinje e familjes Velaj.

Ndërsa për të riun bëjnë me dije se nuk u kishte sjellë kurrë probleme, madje ai kujdesej dhe për mirëmbajtjen e tij si dhe për shtrimin e rrugës pranë banesës.

"Ai nuk kishte fare probleme, edhe rrugën ai e ka shtruar, edhe ne kemi dhënë lekë, por nuk pranonte ai. Grua më të mirë se nëna e tij nuk gjen në botë".

8:14 - Shtëpia nuk e mbrojti! Vrasja e Shkëlzen Velajt në lagjen '24 Maji' në Vlorë, shoqërohen 4 persona

Foto ilustruese

Vrasja e Shkëlzen Velajt në lagjen '24 Maji' në Vlorë ka ngritur në këmbë për hetimet Policinë e Shtetit. Deri më tani bëhet me dije se janë shoqëruar 4 persona, roli i të cilëve ende nuk dihet. Ndërkohë që pika kontrolli janë ngritur në Vlorë, Orikum, autostradën Vlorë-Fier, madje edhe në Elbasan për të kontrolluar çdo person të dyshimtë që mund të çojë në prangosjen e autorëve.

8:33 - **ATENTATI ndaj 35-vjeçarit në Vlorë/ Makina u braktis nga autorët, i vunë flakën, policia gjen në 'BMW' kallashnikovin**

Makina ne Vlore

Policia ka nisur kontrollin në zonë për të bërë të mundur kapjen e autorëve të vrasjes së Shkëlzen Velajt në Vlorë. Menjëherë pas ekzekutimit të tij, u gjet një mjet i braktisur i cili ishte duke u shkrumbuar. Policia dyshon se mjeti mund të jetë i autorëve që kryen krimin ndaj 35-vjeçarit.Gjatë kontrollit në makinën tip 'BMW', është gjetur një armë kallashnikov që dyshohet të jetë arma e krimit.Policia ende nuk ka arritur të bëjë të mundur zbardhjen e kamerave të sigurisë së katit të 5 ku banonte viktima, Shkëlzen Velaj.

7:23 - **ATENTATI ndaj Shkëlzen Velaj/ 35-vjeçari u nis me vrap te dera e shtëpisë, autorët e ndoqën nëpër shkallët e pallatit, zbrazën mbi të kallashnikovin. Ndalohen 4 të dyshuar, policia gjen armën e krimit**

Ardi Velaj, vellai i Shkelzen Velajt

Detaje nga ekzekutimi i 35-vjeçarit **Shkëlzen Velaj** në Vlorë janë bërë të ditura. Mësohet se viktima ka qënë duke hyrë për në shtëpi, kur ka vënë re se pranë pallatit ka qenë duke u ndjekur nga një makinë e dyshimtë. Ai e ka lënë makinën e tij ndezur dhe ka ikur me vrap për t'u futur në banesë, në katin e 5 të pallatit. Mirëpo në momentin kur u afrua pranë derës, atentatori ka lëshuar breshëri plumbash, në një distancë të afërt, në drejtim të tij. Në trupin e Velaj është lëshuar një karikator automatiku, që i kanë kushtuar jetën 35-vjecarit.

Autorët pas atentatit janë larguar në drejtim të rrugës së lumit të Vlorës, në afërsi të fshatit Risili pranë "Bay passit" ku kanë braktisur makinën tip BMW pa targa dhe e kanë djegur ndërsa janë larguar në drejtim të paditur. Mendohet se autor të ngjarjes janë më shumë se dy persona. Menjëherë pas ekzekutimit të tij, u gjet një mjet i braktisur i cili ishte duke u shkrumbuar. Policia dyshon se mjeti mund të jetë i autorëve që kryen krimin ndaj 35-vjeçarit.Gjatë kontrollit në makinën tip 'BMW', është gjetur një armë kallashnikov që dyshohet të jetë arma e krimit. Deri më tani bëhet me dije se janë shoqëruar 4 persona, roli i të cilëve ende nuk dihet. Ndërkohë që pika kontrolli janë ngritur në Vlorë, Orikum, autostradën Vlorë-Fier, madje edhe në Elbasan për të kontrolluar çdo person të dyshimtë që mund të çojë në prangosjen e autorëve.

1:47 - **Njoftimi i Policise**

Makin e atentatoreve te Shkelzen Velajt, ne flake

Njoftimi: Vlorë/Informacion paraprak. Rreth orës 23:55, në lagjen "24 Maji", në rrethana ende të paqarta është qëlluar me armë zjarri shtetasi Sh. V., rreth 35 vjeç, i cili ka humbur jetën në Spitalin Rajonal Vlorë si pasojë e plagëve të marra. Gjatë krehjes së zonës, në afërsi të fshatit Risili, nga shërbimet e Policisë është konstatuar duke u djegur një automjet i braktisur , i cili paraprakisht dyshohet se mund të jetë i autorit/ve të ngjarjes. Vijon krehja e zonës nga shërbimet e DVP Vlorë, për kapjen e autorit/ve. Grupi hetimor, në bashkëpunim me Prokurorinë, po punon për identifikimin e autorëve dhe sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

1:40 - **Vrasja e Shkëlzen Velajt në Vlorë, atentatorët djegin makinën, PAMJET që tregojnë mjetin në flakë**

Atentatorët e Shkëlzen Velajt kaë djegur automjetin pak minuta pasi kanë kryer krimin. ***Dosja.al*** ju sjell pamjet nga rruga e lumit të Vlorës, ku shihet në flakë mjeti i atentatorëve. Vendi është rrethuar nga forca policie, ndërkohë që aty shihet se ndodhet edhe zjarrfikësja. Nuk dihet nëse brenda mjetit, siç ndodh rëndom, autorët kanë lënë armën e krimit apo prova të tjera. Gjithsesi, makina do të sekuestrohet dhe do të jetë në duart e kriminalistikës.

01:17 - **U vra në derën e shtëpisë! Dalin pamjet nga vendi ku u ekzekutua Shkëlzen**

Velaj, momenti ku zbresin trupin nga shkallët

Dosja.al ka siguruar pamjet nga vendi ku u vra Shkëlzen Velaj, ngjarje e ndodhur mbrëmjen e sotme. Në videon e mëposhtme, shihet se si trupi i Velajt zbritet nga shkallët, pasi ka ndërruar jetë si pasojë e plumbave që ka marrë.

ETIKETA: #ardi velaj #shkelzen velaj #vritet shkelzen velaj

7 SHARES

Previous article

U vra në mes të Vlorës, Artan Hoxha tregon detajet: Kam udhëtuar në skaf me Delon Troqen, çonim turistë në Karaburun

Next article

Vritet me armë zjarri në lokalin e tij 62-vjeçari në Lushnje, i biri rëndë në spital! Ngjarja pas një sherri, autori i dehur shkoi dhe mori kallashin. Policia e prangosi për disa minuta, pritet DËSHMIA

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME



Vrasjet e Vlorës fusin në sherr policinë, shefat e rrethit të pakënaqur: Nga Tirana na...



Shtëpinë e kishte 'blinduar'/ I ruhej një atentati të mundshëm, Shkëlzen Velaj kishte...

Ishte bamirësi i lagjes! Kush është Shkëlzen Velaj, s'iu kursye jeta para syve të...



Ekzekutimi i Shkëlzen Velajt/ Forcat Speciale RENEA zbarkojnë në Vlorë, në kërkim të...

dosja.al
ME RITMIN E NGJARJES

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

info@dosja.al +355 682676444

Stafi

Drejtor : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :
Kejsi Muça
Dezdemona Kolaveri
Izmir Akulli
Daniela Andrellari
Eda Kola
Florida Mingla
Alberta Boseta
Kleida Muka
Orgeta Likaj

© 2021 Dosja. Të gjitha të drejtat e rezervuara.